

PROF. DR. HFZ

HAJREDIN HOXHA

TARIKATI  
BEKTASHIAN

Hyrje në historinë dhe bindjet e tij,  
sipas burimeve bektashiane





# Tarikati bektashian

*Hyrje në historinë dhe bindjet e tij*  
*Sipas burimeve bektashiane*

---

**Doc.Dr.Hfz. Hajredin Hoxha**

Profesor asistent i studimeve islame  
College of Community - Taibah University,  
Medineja e Ndrishme – Mbretëria e Arabisë Saudite

Recesent: Ajni Sinani

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

*Parathenje me rendesi!*

Te gjitha falenderimet i takojne Allahut xh.sh. Krijuesit te gjithesise. Salavatet tona qofshin per zoteriun e pejgambereve dhe krijeses me te bukur; Muhamedit a.s., familjes se tij, shoqeve te tij dhe mbi ata te cilet e ndoqen dhe ndjekin rrugen e tij deri ne ditën e fundit te kesaj jete.

Lexues te nderuar!

Deshti Allahu Fuqiplot qe kamba jone te shkele Lindjen e Mesme dhe Azine Juglindore: (Siria, Arabia Saudite dhe Malajzia), per kerkimin e diturise. Poashtu deshti i Madhi Zot qe ne pasi u edukuam per veti; t'i edukojme te tjeret (te punojme si profesore akademik neper univerzitetë te tyre) po ne ato vende dhe vende tjera, Kuala Lumpur-Malajzi, Medine-Arabia Saudite, Brunei, Katar. Po ashtu deshti Allahiu xh.sh. qe ne te udhetojme neper shume vende dhe vise te ndryshme te botes per seminare nderkobetare ku karakterizohen me besime te ndryshme, ne Singapor, Indonezi-Xhakarta, e se fundit ishte edhe vizita jone ne Japoni (Osaka dhe Kyoto) vendlindja e Budizmit ne bote. Gjate tere ketyre viteve me studim dhe me pune ne hasem ne popuj te ndryshem me besime te ndryshme. Bashkejetuam me ta, punonim me ta dhe quam nje jete humane te qete dhe me tolerance fetare. Patem rastim me punue me Kinez, Indian (Budist dhe Hindus), Malajzian, Arab, Turk etj.

Gjate tere kesaj periudhe une verejta popuj me besime te ndryshme, koncepte te ndryshme, filozofi te ndryshme. Isha kurioz te di me shum per ata popuj dhe keshtu iu mvesha humumtimeve shkencore ne fushen e religjioneve komparative ne bote; bile isha gadi shpirtnisht dhe psikikisht dhe ende jam

gadi, qe ta kryej edhe nje shkalle te Doktoratures per kete qeshtje. Gjate studimeve te mia ne fushen e religjioneve komparative pata rastin ta bej nje studim per enciklopedine e Imam ibn Hazmit ne kete fushe: *El Fisal fil Mileli ve En Nihal*, pastaj pata rastin te bej nje studime per Imam Ebu Rejhan El Bejrunit dhe enciklopedine e tij fetare per Indine: *Dhikru ma lil Hindi min mekuletin; mekbuletin fil akli ev merdhuletin*. Pastaj paten rastin te bejme edhe studime te fraksioneve fetare te ndryshme, sufiste, shiite, dhe devijimet e tyre ne komentimin e Kur'anit, etj.

Normal kur popujt largohen nga urdherat kur'anore dhe atyre profetike( Kur'ani dhe Sunneti) padyshim se ata do te devijojne dhe do ta humbin rrugen e tyre.

Gjate studimeve tona posdiplomike ne patem nderin ta bejme nje studim edhe per tarikatin Bektashi. Per kete studim na shtyri profesori i lendes: Religjionet Komparative, prof.Dr.Irfan Abdul Hamid Fettah, nga Iraku, Allahu e meshirofte.

Pasi qe ai ishte ekspert per ne kete fushe, une besoj se ai qellimisht i udhezonte studentet e tij ne keto fusha per ta kuptuar realitetin e fraksioneve fetare te shumta dhe te devijuara ne menyre qe studenti te pregaditet ne kete fushe. Ai me rekomandoj per mua Tarikatin Bektashi.

Kur une iu mvesha kesaj pune ne gjuhen angleze, e pastaj ne gjuhen arabe, dhe perplot tre muaj hulumtimi dhe lexim te papushuar; arita ne shume rezultate mahnitese dhe nuk mujta me i besue syve te mi, se keshtu eshte halli dhe realiteti i tarikait Bektashi! Nje konglomerat besimesh, bindjesh te perziera, te sufive devijuara, shiave, krishtereve, alevive, hinduizmit!! etj.

Kur e prezentova punimin tim para prof. Dr. Irfan Abdul Hamid Fettah-hut, Allahu e meshirofte; ai ma dha noten e plote. Une i

thash: por ky studim, prezentim e besimeve te tyre meriton studim kritik, analize, debat, shqyrtim, replike, etj etj, ai me tha: per kete periudhe te studimeve pos diplomike-Master dhe Doktorature, mjafton te prezentohen besimet e tyre ashtu sic besojne pa shtuar fare asgje, pa kritikuar asgje. Kur ju mbaroni studimet tuaja dhe perforcoheni ne shkenca Islame, beheni profesore;atehere beni analiza kritike, shqyrtoni, debatoni, refuzoni me argumente te vertetea, te logjikshme te bazuara ne Kur'an dhe Sunnet.

Dhe kjo ndodhi faktikisht me rastin tim. Une ne kete studim, prezentim jam munduar me i paraqitur opinionit dhe publikut te gjere ashtu si besojne bektashite pa kritikuar asgje, dhe lexuesi ka per te vrejtur kete realitet.

Inshalla, nese kemi jete te gjate ma vone, apo dikush tjetër vazhdon kete mision, ky studim dhe ky prezentim duhet elaboruar shkencërisht rishtaz ne mnyre sistematike per hir te Allahut xh.sh. dhe per hir te diturise. Duhet bere e qarte ajo cka eshte e vertete dhe ajo cka nuk eshte e vertete me argumente, me studim te qete, dialog te qete, analize te qete. Kush e pranon e pranon, e kush nuk e pranon ai eshte i lire, dhe nuk jemi pergjegjes per udhezimin apo devijimin e askujt.

Ky ishte tregimi dhe realiteti i ketij studimi, me te cilin lus Allahun xh.sh. mem shperblye ne ditën e gjykimit. Amin

Me respekt

**Hfz.Hajredin Hoxha**

College of Sharia and Islamic Studies

Qatar University

Doha-Qatar

16.06.2013

## *Kreu I:*

### **HISTORI E SHKURTËR E TARIKATIT**

A- Periudha e parë, nga themelimi i tarikatit rreth vitit 1250 deri në kohën e Sulltan Selimit, rreth vitit 1500.

#### *1- Kushtet e Anadollit në shekullin XIII*

Për ta kuptuar më mirë një dukuri ose bindje, u duhet hedhur një vështrim kushteve shoqërore dhe fetare të kohës. (Shih: *The Bektashi Orders, John Kingsley Birge*, f. 22). Për të marrë informacion thelbësor të qartë rreth tarikatit bektashi, duhet të studiojmë qoftë edhe shkurt disa ngjarje historike që kanë ndodhur në kohën e lindjes së tij. Në rastin e bektashizmit, si “*konglomerat shumë besimesh*” (*Islam Ansiklopedisi – botimi i fundit, vëll. 1, f. 46*) nga ide të krishtera, islame, greke e pagane.

Duke kuptuar sfondin e tij historik mund të jemi në gjendje të kuptojmë se si lindi ky tarikat, dhe do të mund të gjejmë burimet e rritjes së tij.

Mirëpo, historia e Anadollit duket çështje shumë e vështirë dhe e ndërlikuar për t’u studiuar. Gjetja e së vërtetës dhe prejardhjes së turqve të vjetër, gjegjësisht selxhukëve, dhe bindjeve të tyre heterodokse nuk ka qenë një detyrë e lehtë për mua dhe të tjerët. Kjo për shkak të mungesës së burimeve dhe referencave të rëndësishme, shumë prej të cilave kanë humbur ose janë djegur siç kanë theksuar orientalistët e njohur turq. Gjithashtu, studimet rreth kësaj teme kanë qenë mjaft të kufizuara. (Shih: *Islam In Anatolia after the Turkish Invasion, Mehmet Fuad Koprulu*, tr. Gari Leiser, f. 3), dhe veç kësaj ka pasur arsye të rëndësishme politike, ekonomike dhe konflikte që i kanë shtyrë turqit të shpërngulen në Anadoll nga pjesë të ndryshme të Azisë. (Shih: *Anadoluda Islamiyetin Yayilisi, Osman Cetin*, ff. 61-85)

Ne do të mbështetemi në veprën e studiuesit më të njohur të bektashizmit në Perëndim, John Kingsley Birge, me të cilën ai mbrojti doktoraturën në Stamboll. Studimit të tij do t’i referohemi sa të mundemi, për shkak të mungesës së burimeve dhe referencave rreth kësaj çështjeje. Le të fillojmë me atë që ai ka shkruar dhe studiuar rreth kësaj teme.

Ai shkruan:

“Shumë kohë përpara fillimit të shekullit, depërtimi i Azisë së Vogël nga kishte filluar. Forcat e turqve ollyzë kishin hyrë në Azinë e Vogël qysh më 1037 kur kishin mundur një forcë bizantine në brigjet e liqenit Van, duke vrarë 24000 ushtarë të krishterë. Megjithatë, pushtimi kryesor i vendit nga turqit ndodhi thajse menjëherë pas Betejës më

1071. Pasi perandori bizantin Roman Diogjeni ishte mposhtur nga Alp Arslan, selxhuku i madh në Malazgirt, pushtimi dhe komandimi i trashëgueshëm i provincave të Perandorisë Romake nga Erzurumi në Konstantinopojë iu besua nga Alp Arslani Sulejmanit, birit të Kutlmushit, i cili sikurse vetë Alp Arslani kishte prejardhje selxhuke. Sulejmani me katër vëllezërit e tij kaluan Eufратin, dhe në një kohë pabesueshmërisht të shkurtër përshkuan krejt Azinë e Vogël dhe ngritën kampin e tij në Kutahja. Më vonë, ai ngriti pallatin e vet në Niçe, pasi forcat e tij ishin shtrirë brenda gjashtë vjetësh nga Eufратi në Konstantinopojë, dhe nga Deti i Zi në Siri. (*The Bektashi Order of Dervishes*, ff. 22-23)

Pas kësaj hyrjeje të shkurtër, autori analizon disa nga faktorët që i bënë ata ta përparonin në territore që komandanti selxhuk nuk kishte planifikuar t'i pushtonte:

“Fillimisht ndodhi përçarja e ushtrisë bizantine. Ajo ishte mposhtur rëndazi në betejë dhe komandanti i saj ishte kapur nga Isak Komneni, gjenerali që e pasoi në autoritet. Ushtria me fuqitë e saj nuk ishte më në gjendje të ofronte qëndresë të sigurt. Kushtet mbizotëruese shoqërore tek fshatarët e varfër prireshin t'i tëhuajësonin banorët vendas nga autoriteti bizantin. Një pjesë e konsiderueshme e këtyre fshatarëve kishte qenë krejtësisht nën sundimin e latifondistëve të pasur dhe ishin të gatshëm të dëgjonin premtimet e një fuqie rivale. Shumë prona punoheshin nga skllevërit. Sulejmani i deklaroi të lirë pas pagimit të një takse të caktuar, duke fituar kështu simpatinë e tyre. Një faktor i tretë ishin rojet e kufirit, të cilëve u ishte besuar përgjegjësia e mbrojtjes së perandorisë nga pushtuesit muslimanë dhe mësymjet e banditëve dhe të cilët ishin të gatshëm të luftonin për cilëndo palë. Akritëve në anën bizantine u përkonin gazitë, ose pushtuesit fetarë, në frontin musliman. Në leksionet e tij mbi historinë e turqve në Rum, Dr Vitek na ka treguar se sa të rëndësishëm ishin këta luftëtarë, dhe se si mendësia gazite ua ndezi shpirtrat danishmentëve, pushtuesve selxhukë dhe turq më së paku deri në epokën e Sulltan Muhammed pushtuesit.

Një faktor i pestë ishin popujt nomadë turq. Sa herët filloi ky depërtim nga fise turke është e paqartë, por historiani turk Prof. Fuad Koprulu ka treguar në veprën e tij *Les Origines de L'Empire Ottoman* se aty nga mesi i shekullit të trembëdhjetë Anadulli ishte kryesisht turk, me një popullatë të përbërë kryesisht nga këta popuj turkmenë (*The Bektashi Orders of Dervishes*, f. 24; shih edhe *Islam Ansiklopedisi*, 2-Cilt, 461).

Pastaj autori i këtij studimi na ofron detaje dhe informacion rreth shtetit selxhuk dhe disa shtete të tjera rivale islame që ishin pushtuar, si dhe çfarë ndodhi me disa sundimtarë dhe princër. Të shohim shkurt se si i shtjellon autori këto ngjarje të rëndësishme historike:

“Aty nga fillimi i shekullit XIII, kryeqyteti i shtetit Selxhuk ishte zhvendosur nga Konia, dhe shtatë sundimtarë selxhukë ishin ngjitur në fron. Shtete islame rivale, sidomos danishmentet e Sivës dhe Malatijës ishin pushtuar dhe përpara se të niste shekulli, Kilic Arslan II ndihej aq i sigurt saqë e ndau perandorinë mes njëmbëdhjetë djemve të tij (*Encyclopedia of Islam, Seljuks*). Pas Perandorisë Latine në Konstantinopojë më 1204, turqit u bënë aleatët e grekëve dhe armiqtë e kryqtarëve dhe aleatëve të tyre, armenëve. Era e artë e selxhukëve erdhi me sundimin e Alaeddin Kejkubadit I (1219-36). Pasi kaloi shumë vite si ekzil në Konstaninopjë, Alaeddini ishte njeri i shkolluar, i njohur me Krishtërizmin. Gjatë sundimit të tij të ndritur ndodhi era e madhe ndëruese që ka lënë deri sot mbetje arkitekturore të një shkëlqimi të madh. *Konia, Sivas, dhe Alaja* në veçanti ishin zbukuruar me pallate, xhami, kolegje teologjike dhe ndërtesa të tjera të ngritura kur arti selxhuk ishte në kulmin e vet.” (*The Bektashi Order of Dervishes*, ff. 24-25)

Më vonë Alaeddini kreu vepra të mëdha. Ai e zgjeroi territorin deri në Seluçi dhe i detyroi ushtritë armenase të paguanin taksa, dhe zaptoi disa qytete si Ahlati mbi liqenin Van, kurse më 1236 ai lëvizi gjithashtu kundër *Harezm Sah Celaludin* i cili kërkonte të zaptonte Ahlatin dhe Azinë e Vogël, dhe kur beteja e ashpër u zhvillua pranë Erzinxhanit, Alaeddini ngadhënjeu. Dhe më vonë më 1243, pasuesi i Alaeddinit, *Giyasuddin Keyhusrefe II* i quajtur në një vend *Kosedag* u mund keqas nga perandori mongol Hulagu, dhe u detyrua të paguante taksa dhe haraçe. Që prej asaj kohe selxhukët e humbën pavarësinë e tyre. Më vonë ata kërkuan ndihmë nga memlukët e Egjiptit kundër mongolëve. Fitorja e memlukëve u pasua nga një humbje e rëndë, dhe qytete si Sivas dhe Cesarea u zaptuan nga mongolët më 1243, dhe njerëzit e atij qyteti u masakruan dhe përjetuan gjenocid, qytetet u dogjën dhe që prej asaj kohe (1248) Azia e Vogël u sundua nga mongolët. (*Ibid*, f. 26)

Si rezultat i fitores së mongolëve mbi selxhukët, emirët turq më në fund ngritën shtete të pavarura në pjesë të tjera të Anadollit, dhe ajo që njihej si shtet i bashkuar në kohën e Alaeddinit u nda në shumë principata më 1300. (f. 26)

Sipas Kingsley, duhet të ketë njëfarë marrëdhënieje të brendshme, ose racore, apo kulturore mes popullit lokal dhe pushtuesve. Problemi është se sundimtarët turq ishin nganjëherë të përfshirë në marrëdhënie shumë të afërt me sundimtarët bizantin. Për shkak të kryqtarëve dhe në fund mongolëve, aty nga viti 1300 e tërë Azia e Vogël u turqizua.” (f. 26)

Kështu, dy faktorë kryesorë qëndronin pas fillimit të jetës së fshehtë mistike. Së pari, mungesa e sigurisë politike për shkak të luftërave që i çuan njerëzit në pasiguri ndaj jetës së kësaj bote dhe një mospëlqim i saj bashkë me dashurinë e zjarrtë për Zotin, që i çoi shumë njerëz në kërkimin e njëfarë paqeje të brendshme në jetën fetare.



Së dyti, në kontrast me faktorin e parë, kishte diçka të cilën autori e quan *impuls militant dhe dëshirë për të pushtuar botën në emër të fesë*. Ky faktor u pa te gazitë kur pushtuan Anadollin për herë të parë, dhe më vonë tek princat turq që e përshkruanin veten kështu (*Ibid, f. 27, c.n.: Wittek, Deux Chapters, Byzantium XI, 1936, f. 302 offset*).

Këta dy faktorë mund të gjenden në literaturën bektashite deri më sot. Kështu, mund t'i referohemi poezisë së Junus Emresë, *Fevaitnamesë* së Haxhi Bektashit, të cilat janë shprehje të një interesimi të madh me ahiretin. Po ashtu në ngjarjet e pushtimeve nga Aliu, traditat e Sejid Gazi Bottalit, dhe *Vilajetnamenë* e Haxhi Bektash Veliut, dhe *Vilajetnamenë* e Sejid Ali Sulltanit, ku gjenden shprehje të mendësisë gazite. Si rezultat, faktori i parë i ndihmoi njerëzit të prodhonin mistikë si Xhelal ed-Din Rumi, ndërsa i dyti u pa qartë kur bektashinjtë u përpoqën të ndërtonin, organizonin dhe përhapnin tarikatin e tyre (*The Bektashi Order of Dervishes, pp. 27-28*).

Këta dy faktorë mund të jenë themel i fortë për të kuptuar një çështje shumë të rëndësishme në këtë kontekst. Pra, Islami dhe Krishterimi po rriteshin dhe përhapeshin së bashku si rivalë.

Kur kryqtarët kaluan nëpër Azinë e Vogël, ata pushtuan Konian nën Frederik Mjekërkuqin. Nga ajo kohë, në kontakt me kryqtarët muslimanët ishin nën ndikimin e tyre, i cili mund të shihet kur disa princa turq nisën të imitonin të krishterët në monedhizimin e parave sikurse ata. Një tjetër rast ku vëllai i princit të famshëm turk Ruknuddin Suleiman më 1196, ishte në ekzil dhe u strehua te kristianët, dhe pothuajse u bë i krishterë, e u martua me një të krishterë. Kur pasuesi i tij Alaeddini jetoi në Konstantinopojë ai nuk ishte kundër Krishterizmit. Në beteja besimi i tij kryesor ishte te ushtarët e krishterë, dhe ai u dha shumë privilegje tregtarëve të krishterë. E njëjta gjë mund të thuhet për Xhelal ed-Din Rumiun, kryeshenjtorin e tarikatit mevlevi që ishte vetë tolerant dhe miqësor ndaj të krishterëve.

Disa prej atyre që e kanë studiuar historinë e tarikatit bektashi sikurse autori i lartcitur dhe orientalisti i famshëm gjerman Babinger janë përpjekur të konfirmojnë llojin e Islamit që u përvetësua nga sundimtarët selxhukë ishte si doktrinë shiite për shkak të ndikimit të safavidëve (*The Bektashi Order, f. 29*). Për më shumë detaje rreth lindjes së safavidëve, shih artikullin: "Muslim Religious Trends under the Timurids and the Rise of the Safavids", në Mehmet Fuad Koprulu, *Islam in Anatolia After Turkish Invasion, f. 39*).

Megjithatë, kjo ide u mohua nga disa orientalistë turq, sikurse Fuad Koprulu, i cili pajtohet veçanërisht me citimin e Dr Osman Cetin nga Ibn Battuta, sikurse respekti i Dymbëdhjetë Imamëve dhe venerimi i Sejjidina Aliut, respekti sufi për Shejhun, etj.

Por në literaturën turke kam gjetur diçka që kundërthotë pohimin e parë, pra se thujse të gjithë selxhukët kanë qenë shiitë dhe alevi.

Shkrimtari turk Dr. Osman Cetin në librin e tij në turqisht *Anadoluda Islamiyetin Yayilasi*, f. 163 ka shkruar:

*“Ibn Batutanin asagidagi ifadeleri herhangi bir karineye ihtiyac duymadan Anadolunun suninlige shadet eder: “Ulke Anadalu halki butunuyle Imam Ebu Hanife Allah (c.c.) ondan razi olsun, mezhebinden (Hanefi ) olup Ehli Sunnetir. Aralarinda ne Rafizi, ne Mutezili, ne Kaderci, nede bid’at ehli bulunmaktadir. Allah Teala Hazretleri onlari bu faziletleri ile ustun kilmistir... Fakat koylerde ... Turkmenlerde ve Iranli unsurlari buluduyu as cok.”*

Që do të thotë: Nga udhëtari i famshëm islam Ibn Batuta nuk mund të gjejmë as edhe një tregues që konfirmon se ata ishin alevi ose shii. Ai shkruan: e tërë popullata e Anadollit ishte e medhhebit të Imam Ebu Hanifes, Allahu qoftë i kënaqur me të, dhe që të gjithë ishin sunni mes tyre nuk mund të gjejmë asnjë rafidi, mu’tezili, kadiri. Nuk kishte as bidatçinj. Ky ishte vullneti dhe mbrojtja e Allahut për ta. Kishte njëfarë ndikimi në disa fshatra, por ky ishte fare i vogël.

## *2-Marrëdhënia mes kalenderive dhe bektashinjve*

Pas pushtimit mongol, numri i dervishëve nga Turkistani, Buharaja dhe Harezmi që kërkonin strehim te selxhukët u rrit së tepërmi. Sipas Prof. Fuad Koprulu shumica e dervishëve ishin të sektit kalender, dhe ai e konsideron këtë lëvizje kalenderiste si një nga ngjarjet më të rëndësishme fetare. Ata u tërhoqën nga bota dhe nuk shqetësoheshin për të nesërmen, dhe udhëtonin shumë. Prirja e tyre ishte kah teologjia alevite, dhe ndikimi i tyre mes turkmenëve ishte shumë i madh, dhe me doktrinat e tyre shiite dhe misteret luajtën rol të madh edhe në situatën politike (*The Bektashi Order*, f. 32; *Islam Ansiklopedisi*, 5, 375)

Sipas pohimit të mësipërm si dhe disa referencave të tjera historike mund të themi se:

Në raportin mes tarikateve kalenderite dhe bektashiane mund të gjejmë se prijësi i tarikatit kalender ishte Baba Iljas el-Horasani. Ai kishte pasues të rëndësishëm, që ishin Baba Is’haku dhe Haxhi Bektashi. Ata të dy i përkisnin tarikatit kalenderi. Por pas njëfarë kohe, duket se pati njëfarë debati mes tyre.



Kjo i bëri Baba Is'hakun dhe Haxhi Bektashin të rebeloheshin nga ky tarikat dhe të krijonin tarikatin e tyre, i cili u bë i njohur më vonë si tarikati bektashi. (Shih: *Ahmet Yasar Ocak, Kalenderiler- Osmanli Imperaturlugunda Marjinal Sufilik, XIV-XVII- Yuzyillar, f. 205*), si dhe *Islam Ansiklopedisi, C-5, f. 373*. Për më shumë detaje, shih artikullin: *Muslim Religious Life In Anatolia in the Eighth century and the Rise of the Ottomans në: Islam In Anatolia after the Turkish Invasion, f. 25*).

## **B-Jeta e Haxhi Bektash Veliut – themeluesit të tarikatit**

Haxhi Bektash Veliu është përshkruar nga ndjekësit e tij kështu:

“O kryeshenjtor i nderuar, Sejid Sulltan, Haxhi Bektash Veli, Allahu i Lartësuar ia shenjtëroftë misterin. Ai ngau luanë, fliste me zogjtë dhe drerët, ecte mbi det, fluturoi në qiej mbi lëkurën e luanit, ngjalli të vdekurit, u dha shikim të verbërve, dhe shëroi të sëmurët.” John Kingsley Birge shkruan në veprën e tij *The Bektashi Order of Dervishes*:

”Si ndihmues në kujtesë dhe në përputhje me një zakon të mirënjohur universal në Lindjen muslimane, jeta e Haxhi Bektash Veliut përmbledhet te bektashinjtë në katër fjali, ku fjalë të caktuara të secilës përmbajnë gërma, vlera numerike e të cilave shpjegon një fakt ose një tjetër në kronologjinë e jetës së shenjtorit. Katër fjalitë janë këto:

1. *Hazreti Pirin veladeti müruwet,*
2. *Horasandan Ruma tesrif eder, reft,*
3. *Müddeti ömrü Muhammad dir cemali,*
4. *Bektasiye tarih asvabi rihlet,*

1. Hazreti Pirin veladeti müruwet, “Lindja e Kryeshenjtorit, bujaria e shpirtit.” Fjala *müruwet* me katër gërmat e saj në arabisht:

mim - 40,  
re - 200,  
ve - 6,  
te - 400

Shuma e këtyre numrave del 646, që pranohet si viti i lindjes së tij sipas kalendarit hixhri (1248 A.D.)

2. Horasandan Ruma tesrif eder, reft. Ai erdhi nga Horasani në Rumin e këndshëm. *Reft* ka vlerën numerike të mëposhtme:

re - 200,  
fe - 80  
te - 400;

që jep vlerën 680, i cili merret si viti i ardhjes së tij në Anadoll, në moshën tridhjetë e katër vjeçare (1281 AD).

3. Müddeti ömrü Muhammad dir cemali. "Gjatësia e jetës së tij është bukuria e Muhammedit." Kësaj radhe jo fjala e fundit, por fjala Muhammed jep numrin e viteve të jetës së tij:

Mim - 40,  
Ha - 8,  
mim - 40,  
dal - 4  
që jep 92.

Ky numër pranohet si numri i viteve që ai jetoi.

4. Bektasiye tarih asvabi rihlet. Data e vdekjes së tij, 738 A.H. (A.D. 1337) përfaqësohet nga fjalia e katërt "Data e vdekjes së Bektashit, shumë e vërtetë." Në këtë fjali, si fjala *bektashije* edhe fraza *asvabi rihlet* janë baras me 738:

be - 2,  
kef - 20,  
te - 400,  
elif - 1,  
sin - 300,  
be - 10,  
he -5

japin 738. Dhe

elif - 1,  
sad - 90,  
vav - 6,



elif - 1,  
be - 2,  
re - 200,  
ha - 8,  
lam - 30,  
te - 300

japin 738. (*Shih: The Bektashi order of Dervishes, f. 34*)

Ai ishte ndër prijësit shpirtërorë që fituan spikatje të madhe për fuqitë mrekullibërëse mes avamit, si muslimanë ashtu edhe të krishterë *سريعي التصديق*. Prejardhja e Bektashit kthehet deri tek Profeti a.s. Kjo përmendet në Vilajetnamenë e Haxhi Veli Bektashit, me këtë linjë:

1. *Muhammedi a.s.*
2. *Fatimja e bija e Pejgamberit a.s.*
3. *Imam Huseini*
4. *Imam Zejnul Abidini*
5. *Imam Muhammed el-Bakir*
6. *Imam Xhafer es-Sadik*
7. *Imam Musa el-Kadhim*
8. *Sejid Ibrahim el-Muxhab*
9. *Sejid Musa Thani*
10. *Sejid Sulltan Ibrahim Thani*
11. *Haxhi Bektash Veli*

Babai i tij Sejid Sulltan Ibrahimimi ishte sundimtar i një krahine në Horasan. Kur shenjtori i ardhshëm u lind, ai u quajt Bektash, që do të thotë “shok në rang”, ose “i barabartë me princin”. Atë e dëgjuan të recitonte shehadetin në djep. (*The Bektashi order of Dervishes, f. 36*)

Ai lindi në qytetin e Nishaburit në Horasan. Babai i tij ishte Sejjid Ibrahimimi, ndërsa e ëma Hatem Hatun nga Nishaburi.

Haxhi Bektash Veliu i kaloi 25 vjetët e para të jetës në Nishabur, ku mësoi filozofi, fizikë, letërsi e shkenca të tjera nga dijetarë të Turkistanit, të prirë nga Lukman Perende. Ai e rriti dijen e tij me udhëtime të shumta në Turkistan, Iran, Bagdad, Kerbela, Mekë dhe Siri.

Pastaj u zhvendos në Anadoll dhe u vendos në *Sulucakarahuyuk*, emri i sotëm i të cilës është Haxhibektash, me ftesën e Ahmed Jeseviut. Ai e zhvilloi mendimin e tij në qendrën e kulturës turke që ngriti atje,

duke marrë me vete një numër të stërmadh nxënësish dhe luajtur rolin e prijësit ushtarak, shoqëror dhe fetar mes turqve anadollas, duke zgjidhur gjithashtu problemet e popullit me ushrinë.

Pasi u martua me Fatma Nuriye Hanëm (Kadinxhik Ana), të bijën e Idris Hoxhës, Haxhi Bektash Veliu nisi udhëtime të gjerësishme në rajone të Anadollit të banuara nga turq, studioi zakonet dhe traditat turke, që ishin mbajtur të paprekura deri atëherë, përzjeu besimin islam dhe kulturën turke dhe themeloi filozofinë e tij mbi këtë pajtim. I njohur edhe si shenjtori themelues i jeniçerëve, ai ishte vendimtar në krijimin e bashkimit turk në Anadoll, ngriti statusin e gruas në jetën shoqërore dhe vazhdoi për tërë jetën ta mbronte gjuhën dhe kulturën turke nga ndikimet e huaja dhe futjet heretike. Besohet se vdiq më 1337. Haxhi Bektash Veliu është varrosur në faltoren e tij në qytetin Haxhibektash.

Ai ka shkruar libra me titujt *Makalat*, *Fevaid*, *Sadhijje* dhe *Sherh-i Besmele*. Vepra e njohur si *Vilajetname* është një burim i rëndësishëm për njohjen me jetën dhe mrekullitë e Haxhi Veli Bektashit.

Sipas opinionit të disa studiuesve, themeluesi i vërtetë i tarikatit ka qenë predikuesi dhe kalenteri Haxhi Bektash Vali Nishpuri Horasani (1208-1270), i cili shpalli zinxhirin e tij të shpirtshëm si të buruar nga shejhu i Turkistanit Ahmed Jeseviu (vd. 1166), dhe përmes atij personi deri te Imami i shtatë shii Musa el-Kadhim. Haxhi Bektashi fitoi shumë shpejt popullaritet të gjerë në Azinë e Vogël. Më 1240 ai mori pjesë aktive në kryengritjen e “të liruarve turq” që udhëhiqej nga dervishi kalender Baba Is’hak (kundër sulltanit konias Gijath ed-Din Husrov). Nuk ka burime ose shkrime autentike të Haxhi Bektashit dhe nuk mund të gjykojmë rreth mësimit të tij (tradita bektashiane beson se ai ishte autor i trajtesës *Makalat* në arabisht, por origjinali nuk është gjetur; ekzistojnë vetëm dy përkthime poetike në turqisht nga shekujt XIV dhe XVI. Shih edhe: Ahmet Yasar Ocak, *Bektasi Menakib namelerinde Islam Oncesi Inanc Motifleri*, ff. 5-9) Por sipas doracakëve të mëvonshëm të lutjeve, riteve dhe rregullave fetare, mund të hamendësohet se Haxhi Bektashi (sikurse shumë predikues të tjerë lëvizës në Turqi) predikonte idetë e kalenderëve dhe (ka mundësi) nocione të shiitëve radikalë (gulatë). (Shih: *Islam Ansiklopedisi*, vëll.1, f. 468, botimi i vjetër)

Bektashinjtë u përhapën mes popullatës fshatare. Gradualisht, bektashinjtë u bënë njësi e qëndrueshme me një rrjet të zhvilluar teqesh dhe bashkësish me hierarki të rreptë, sistem ritual të pandotur dhe rite inicimi si dhe simbole të posaçme e veshje të veçantë

الثوب أو الكساء الخاص. (Shih: *The Sufi Orders In Islam*, f. 399)



## 2-Themeluesi i tarikatit

“Figurat legjendare janë pjesë e kujtesës kolektive të njerëzve, ata u lejojnë popujve të frymojnë dhe shijojnë tezat e historisë së tyre me një konkretshmëri që asnjë tekst nuk mund ta barazojë. Veprat e pandehura si dhe të njohura të heronjve fetarë eponimë që shfaqen në historinë e kujtuar të Turqisë përbëjnë një mozaik të pasur, që ofron për një publik të gjerë turk imazhe të paraardhësve të tyre si dhe të institucioneve të tyre shoqërore.

Kështu është edhe me Haxhi Bektash Veliun, një shenjtor osman prejardhja dhe jeta e të cilit nuk njihen akoma mirë. Një pjesë e arsyes së këtij ngulmimi është përfshirja e këtij njeriu të shenjtë në ngjarjet që shenjtan themelimin e Perandorisë Osmane në shekujt XIII-XV.

Ai ishte një lider tipik i migruesve fisnorë turkmenë nga Azia Qendrore, të cilët e ndryshuan strukturën e popullatës së Azisë së Vogël. Këto ndryshime ndodhën mes shekujve XI e XV. Islami kishte mbërritur në Azinë Qendrore në fillim të shek. IX, por vetëm duke hyrë në qendrat kulturore islame më qendrore të Azisë Perëndimore që turkmenët nisën të merrnin një dije më shumë se sipërfaqësore të fesë së tyre (Shih: *Turkiye Diyanet vakfi- Islam Ansiklopedisi, under the Bektashiya, c-5, f. 373*)

## 3- Reforma në tarikatin bektashi

Ky shndërrim i tarikatit në një organizatë të rrënjosur lidhej me veprimtarinë e Shejhut të madh Balim Sulltan (vd. 1516), titull fetar i të cilit ndër besimtarë ishte Piri i Dytë. Balim Sulltani u vetëshpall pasardhës i Haxhi Bektash Rumiut dhe reformoi strukturën e bashkësive dhe teqeve, renditjen e riteve të inicimit dhe mesa duket vendosi praktikën e beqarisë. (Shih: *Islam Ansiklopedisi, Vol. 2, f. 461, botimi i vjetër*).

Por disa anëtarë të tarikatit e refuzuan reformën e Balim Sulltanit. U shfaqën dy grupe ndërluftuese ndjekësish. I pari përbëhej nga çelebij, pra pasardhës të Haxhi Bektash Rumiut dhe ndjekësve të reformave të Balim Sulltanit. I dyti përbëhej nga baballarët, që ishin të sigurt se vetëm ata ishin ndjekësit e vërtetë të mësimin të themeluesit të bektashive; ata luftuan kundër reformave. Kjo skizmë e futi tarikatin në konflikte dhe përplasje serioze.

Në fund, çelebitë morën në dorë vendin e kreut të teqesë mëmë (*Pir-evi*) si dhe të rolit udhëheqës në tarikatin, përfshirë rangun e kreut të tarikatit (deri në fund të shekullit XVII ekzistonin zgjedhje të kreut të tarikatit; pas kësaj date posti u bë i trashëgueshëm).

#### **4- Zhvillime dhe veprimtari brenda tarikatit**

Në pjesën e dytë të shekullit XVI, kreu i tarikatit bektashi *Sersam-'Alibaba* (vd. 1589) vendosi postin më të lartë të tarikatit, *Dede-baba*. Ndonëse çelebitë e ruajtën pushtetin e tyre të vërtetë brenda tarikatit (kontrollin e vakëfeve, shpërndarjen e përfitimeve, emërimin e krerëve të teqeve lokale, etj), vetëm Dede-baba mund t'i jepte dikujt leje për t'u caktuar në postin e kreut të bektashinjve. Ky post ishte elektiv, dhe tetë baballarë të teqesë qendrore merrnin pjesë në zgjedhjen e Dede-babait. (*Shih edhe: Islam Ansiklopedisi, vëll. 2, f. 162, botimi i vjetër*).

Pjesëtarët e tarikatit bektashi morën pjesë në një sërë kryengritjesh kundër regjimit osman (si p.sh. lëvizja e Kalendarogllut më 1526, e cila u mbështet nga 30,000 bektashi). Pas pushtimeve osmane bektashinjtë u përhapën në Siri, Palestinë dhe Egjipt, ku ishin ngritur teqetë dhe bashkësitë e tyre.

Gjatë udhëheqjes së Balim-Sulltanit propaganda bektashiane gëzoi suksesin më të madh mes pjesëtarëve të trupave jeniçere. Bektashinjtë ishin tejet ndikues mes ushtarëve jeniçerë. Rrethanat përcaktuan rritjen e rëndësisë politike të rendit bektashi në Turqinë osmane. Nga ana e saj, lidhja mes trupave elitë jeniçere dhe vëllazërisë së organizuar bektashite i shndërroi trupat jeniçere në një institucion të mbyllur më vete.

#### **5- Qeveria turke dhe persekutimi i disa liderëve bektashi**

Më 1826 Sulltan Mahmudi II i shpërbëri trupat jeniçere dhe nisi persekutimin e tarikatit bektashi: veprimtaritë e tij u ndaluan, krerët e tarikatit (Dede-baba, Çelebi dhe Dede, që ishte lider dervishë beqarë) u ekzekutuan, teqetë e reja u shkatërruan (në kryeqytet u shkatërruan edhe të vjetrat), vakëfet, tokat dhe ndërtesat e tarikatit u konfiskuan, shumë shehlerë dhe pjesëtarë të thjeshtë të tarikatit u internuan, dhe teqetë lokale iu dhanë tarikatit nakshbendi. Këto persekutime nxitën mërgimin e pjesëtarëve të tarikatit bektashi në Ballkan, sidomos në Shqipëri ku teqe të reja të rëndësishme u ngritën në Tiranë dhe Akçe Hisara; tërë

bashkësitë e vendasve atje u bënë pjesëtarë të këtij tarikati, duke protestuar kundër Islamit sunni të pushtuesve turq. Por gjatë sundimit të Sulltan Abdul-Mexhidit (1839-61) tarikati u ringjall dhe i rifitoi qendrat e tija të humbura.

Gjatë udhëheqjes së Ahmed Xhelal ed-din Çelebiut ndodhi konflikti përfundimtar mes çelebive e baballarëve. Tarikati u nda jozyrtarisht në tri degë: bektashitë, dedetë (armiqtë e tyre i quanin kaxharë, d.m.th banditë) dhe çelebitë (të quajtur murtedë – apostatë nga grupi i parë).

Më 1925 qeveria republikane e Turqisë i ndaloi të gjitha tarikatet, përfshi bektashinjtë. Ka të dhëna se bektashinjtë kanë qenë aktivë në Shqipëri edhe më 1967. Mirëpo sipas burimeve të tjera që janë zbuluar, tarikati bektashi ishte shkëputur dhe pavarësuar plotësisht nga Stambolli qysh më 1922, ndërsa më 1929, anëtarët e tarikatit bektashi mbajtën kongresin e tretë ku deklaruan publikisht pavarësinë nga qeveria turke, dhe ishin nën bashkësinë islame sunnite në Shqipëri. (Shih: *Zhvillimi i Kulturës Islame te Shqiptarët në shekullin XX*, f. 12, A.I.I.C.T, Tiranë: 1998).

Tarikati Bektashi është aktiv edhe në ish Jugosllavi. Deri më 1965 ka pasur një teqe shqiptare në Kajro. Në Turqi (1952) kanë ekzistuar rreth 30000 anëtarë të tarikatit bektashi. Më 1953-4 ata nisën veprimtari të forta politike në Stamboll, që nxitën shtypjen qeveritare.

Në periudhën e tyre formuese, bektashinjtë ishin të lidhur ngushtë me lëvizjen e gazive që bënë shumëçka për fitoren e osmanëve. Kjo rrethanë i dha tarikatit reputacionin e vëllazërisë sunnite, zinxhiri (*silsile*) i të cilit kthehet deri te kalifi i drejtë Ebu Bekr (vd. 635). Por me kalimin e kohës, doktrina e tarikatit u bë objekt ndikimesh të fuqishme trendesh asketo-mistiko-ezoterike (sikurse kalenderitë e melemetitë, shih *The Sufi Orders in Islam*, f. 393 për dallimin mes këtyre dy grupeve).

Si shumë dervishë me prejardhje të njëjtë, Haxhi Bektashi ishte edhe zëdhënës i mjerimeve shoqërore të turkmenëve, që shfrytëzoheshin nga sundimtarët. Dihet gjithashtu se ai u përfshi në kryengritje shoqërore kundër sundimtarëve selxhukë të drejtuar nga Baba Iljasi (~ 1240). Më vonë ai dhe Baba Is'haku u rebeluan nga tarikati kalenderi siç përmendëm, dhe ai ngriti tarikatit e tij të quajtur bektashi.

Ndikimi i Haxhi Bektashit u institucionalizua fuqimisht nëpërmjet identifikimit të tij me një organizatë fetare sufiste, mistike, pra tarikatit bektashi. Ky tarikat kishte si mision t'i bënte muslimanë më të mirë ato grupe për të cilët Islami ishte akoma formal dhe jo i rrënjosur në zemër, të cilat fshihnin shumë praktika heterodokse. Megjithatë, ai e mori formën përfundimtare në shekullin XVI në kohën e udhëheqjes së Balim Sulltanit. Përdorimi i fjalës "sulltan" këtu është thjesht tregues i prestigjit dhe ndikimit. Bektashinjtë kishin nisur tashmë të merrnin përsipër



patronazhin fetar të një formacioni të ri ushtarak osman, jeniçerët në stadin e tyre të hershëm. Ata ishin trupa elitare të sulltanit osman. Kjo organizatë u mëkëmb plotësisht në kohën e Muradit II (1446-51). (Shih: *Turkiye Diyanet Vakfi Islam Ansiklopedisi. Vol. 2, f. 461*).

Sistemi i jeniçerëve u themelua mbi bazën e rekrutimit të djemve të rinj të aftë nga familje të krishtera, të cilët konvertoheshin më vonë në Islam dhe integroheshin në shoqërinë osmane, nga një jetë e afërt me familjet turke. Ato integroheshin edhe më tej në sistemin politiko-ushtarak osman nga stërvitja që merrnin në garnizone. Përvoja e hershme e integritit të mësimeve në drejtbesimin qendror i përgatiste bektashinjtë për këtë detyrë shtesë dhe paskëtaj ata u bënë një vegël më e përgjithshme për qeverinë osmane në promovimin e drejtbesimit në perandorinë osmane që po lindej. (*Ibid*)

Lidhja mes jeniçerëve dhe bektashive si mbrojtës dhe kujdestarë vazhdoi deri në fillim të shekullit XIX. Mosbindja në rritje e jeniçerëve dhe përfshirja e tyre në konfliktet politike ndërkohë që një sërë sulltanësh po përpiqeshin të krijonin ushtri të disiplinuar sipas modelit perëndimor i bëri ata gjithnjë e më jopopullorë te sulltanët osmanë dhe reformatorët e shtetit. Këta të fundit gjithashtu preferonin një Islam mesatar besimdrejtë si ideologji që do përdorej për mobilizimin dhe njësimin e të nënshtruarve të tyre muslimanë. Përfundimisht, Sulltan Mahmudi II i shfarosi jeniçerët duke përdor topa për të shkatërruar barakat e tyre (1826).

Trupat jeniçere u ndaluan dhe tarikati bektashi u nxor jashtë ligjit. Prona e tyre iu transferua tarikatit rival nakshbendi. Megjithatë kjo nuk duket se i ndaloi veprimtaritë në ilegalitet të bektashive gjatë shekullit XIX. (*Islam Ansiklopedisi, vol. 5, f. 374-5, botimi i ri*)

Ironikisht, ndërkohë që aleanca e trupave jeniçere me bektashinjtë punoi në një drejtim anti-reformist, idetë e bektashinjve – në vetvete dhe për shkak të përmbajtjes së tyre heterodokse – kishin pikë puqeje me mendimin liberal të filozofëve të shekullit XVIII në Francë, çka nënkuptonte se bektashinjtë mund të vendosnin kontakte të lirshme me një prej rrjeteve që mbartën idetë e filozofëve të shekullit XVIII, gjegjësisht masonët e lirë. Mesa duket kjo lidhje mund të ndiqet në erën që pasoi vendosjen zyrtare të një periudhe reformash shoqërore, ekonomike dhe politike më 1839, e cila njihet në historinë turke si Tanzimat. (Për më gjerë rreth tanzimatit, shih: *The Bosniaks and the Challenges of Modernity: Late Ottoman and Hapsburg time* nga Fikret Karcic, Sarajevë: El-Kalem, 1998)

Në të dyja shtetet e rëndësishme reformuese figurat reformuese shfaqen si masonë gjatë shekullit XIX, kur masonët francezë dhe anglezë hapën degë në Stamboll. Kjo anëtarësi u rrit në vitet e fundit të shekullit XIX dhe në mesin e kundërshtarëve të Sulltan Abdulhamidit II (s. 1876-1909), të njohur si Xhonturqë. (Të shihet edhe: English translation by

Prof. Evgeny Torchenov of "Bektashiya" from "Russian Encyclopedic Dictionary of Islam" (Moskë: Nauka, 1991, ff. 39-41, nga O. Akimushkin).

Republika turke i ndaloi të gjitha tarikatet, por ato vazhdojnë të funksionojnë në ilegalitet në Turqinë bashkëkohore.

Ja ligji i qeverisë turke që i ndaloi asokohe të gjitha tarikatet.

**Ligji 677:** *Që ndalon dhe anulon profesionin e varr-mbajtësit, dhënien e emrave mistikë, dhe mbyll teqetë, zavijet dhe tyrbet. 13 Dhjetor 1925 (1341 H.)*

**Neni 1.** *Të gjitha teqetë dhe zavijet në Republikën turke, qofshin në formën e vakëfit ose nën pronësinë personale të shehlerëve përkatës ose të ngritura tjetërsoj, mbyllën. E drejta e pronës dhe zotërimit të pronarëve të tyre vazhdon. Ato që janë përdorur si xhami dhe mesxhide mund të mbahen si të tilla.*

Të gjitha tarikatet që përdorin përshkrime si shejh, dervish, myhib, dede, çelebi, sejjid, baba, emir, nakib, halife, fallxhi, byjyxhyllëk (magji), yfrykçyllyk (person që pretendon se shëron me anë të frymës), falli, dhe shkrimi i hajmalive për të realizuar dëshirat e dikujt: pretendimi i të gjithë këtyre titujve dhe veshja e kostumit dervish ndalohen. Varret e sulltanëve, varrezat e teqeve mbyllën, dhe profesioni i varr-mbajtësit hiqet. Ata që hapin teqe, zavije, ose tyrbe, dhe ata që i ringrenë ato, ose ata që u japin vende të përkohshme tarikateve ose njerëzve që quhen me cilindo prej emrave mistikë të përmendur më lart ose u shërbejnë atyre, do të dënohen me të paktën tre muaj burg dhe do të gjobiten të paktën 50 lira turke.

**Neni 2.** Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

**Neni 3.** Kabineti ngarkohet me zbatimin. (Të shihet versioni në linjë i *Alevi-Bektashism: The Past and The Present of A Disappearing Turkish Culture*, Gökhan Percin, Stanford University Press. Shih edhe: English translation by Prof. Evgueny Torchenov of "Bektashiya" from Russian "Encyclopedic Dictionary of Islam" (Moscow: Nauka, 1991, ff. 39-41) nga Akimushkin; *Islam Ansiklopedisi*, Vol. 5, p. 374, botimi i ri. Rreth ndalimit të të gjitha tarikateve dhe shkaqeve të kësaj, shih: *The Bektashi Order of Dervishes*, p: 83).

## ***Kreu i dytë: Doktrinat dhe bindjet***

Disa nga parimet e tarikatit bektashi janë këto:

### ***Gjashtë urdhëresat (ahkam):***

1. Njohja mistike (Ma'rifet- المعرفة الباطنية )
2. Bujaria (Sahavet - السخاء )
3. Dija e patundur e paluhatshme (Jekin- اليقين )
4. Besnikëria (Sadakat - الإخلاص و التصديق )
5. Realiteti është brenda vetes (Haki Ozunde Bilmek - معرفة الحق )
6. Soditja (Tefekkur – التفكير )  
(*Shih: The Bektashi Order, f.205*)

### ***Gjashtë shtyllat (arkan):***

1. Dija - العلم
2. Përrulësia-الحلم
3. Kënaqësia - القناعة
4. Mirënjohja - الشكر
5. Lutja e Zotit - الدعاء إلى الله
6. Tërheqja - التقاعد

### ***Gjashtë ngrehinat (bina):***

1. Pendesa - التوبة
2. Dorëzimi - الاستسلام
3. Besnikëria – التصديق
4. Ngritja shpirtërore - الارتقاء الروحي
5. Bindja dhe kënaqja – القناعة و الرضا
6. Veçimi – الخلوة أو العزلة



Këtu qëndron burimi i tolerancës fetare të bektashinjve. Thelbi i doktrinës sinkretike ( المبادئ الأساسية للتوفيق بين المعتقدات الدينية المتعارضة ) të bektashinjve dhe praktikave të tyre është: vetëm i pafuturi në sekretet e udhës mistike duhet t’u përmbahet rregullave të Sheri’atit;

- 1- Kuptimi i fshehur i Kur’anit arrihet vetëm nga të futurit në udhë;
- 2- Mohimi i namazit pesëvaktësh;
- 3- Larja rituale (*gusl*) është e domosdoshme vetëm para ritit të inicimit;
- 4- Agjërimi është i domosdoshëm vetëm gjatë dhjetë ditëve të para të muajit të Muharremit (*gjatë kësaj periudhe pjesëtarët e tarikatit nuk pinë ujë por hanë fruta, perime dhe ushqime të tjera të thjeshta vegjetariane*);
- 5- Netëve të kësaj periudhe ata kremtojnë gjithashtu kujtimin (matem gedjeleri) e martirëve shiite; kultin e pesë të pamëkatëve (ma’sum-i pak); veçanërisht kultin e Xhafer Sadikut; tezën që Aliu është mishërimi i Zotit.
- 6- Dhe mi’raxhi i Muhammedit a.s. është shenjë e pozitës së lartësuar të Profetit pranë Aliut;
- 7- Viti i ri kristian është ditëlindja e Aliut dhe duhet festuar për tri ditë: ata kanë tubime të shenjta ku anëtarët e tarikatit pinë qumësht dhe dëgjojnë muzikë; inicimi (*ayinjam, ainjem*) përbën lavdërimin e Familjes së Profetit (Ehl-i bejt),
- 8- Besimtarët duhet të luten për këtë familje në mëngjes dhe mbrëmje si dhe për vetë Aliun;
- 9- Pas muajit të Muharremit (kur nuk ka pendim) një besimtar duhet t’i rrëfejë një herë në vit babait në teqe mëkatet e veta për t’u shlyer prej tij.
- 10- Gratë e tarikatit bektashi mund të marrin pjesë në shërbimet e tyre.
- 11- Disa bektashi e marrin trinitetin e Aliut, Muhammedit a.s. dhe Allahut si simbol të tarikatit të tyre.
- 12- Të tjerë marrin për simbol të tillë trinitetin e Aliut, Haxhi Bektashit dhe Fazlullah Astarabadiut (themeluesit të hurufizmit, që ishte një mësim mistik shii; ai vdiq më 1394 ose 1401 dhe ndjekësit e tij besonin se ishte mishërim i Zotit).
- 13- Bektashinj të gjithashtu e hyjnizonin dhe adhuronin (يؤلّهون ويعظمون) Fazallahun dhe e morën librin e tij *Xhavidname* (turqisht, *Ashikname*) si shkrim sakral.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Sipas autorit të librit *The Bektashi Order of Dervishes* dhe autorit të librit: *Spiritual Discourse-Learning with an Islamic Master*, Frances Trix, e cila ishte nxënëse e *Baba Rexhebit* në Miçigan për 25 vjet me radhë.

## Së pari: Karakteristika të përgjithshme të tarikatit

- 1- Përshkrimi i Zotit në poezitë e tyre si pronar ose si punonjës që llogarit çdo detaj, sikurse në poezitë e Sulltan Kayguzus (*Shih: The Bektashi Order, p. 90*).
- 2- Përshkrimi i veprave të një besimtari si të padobishme, siç mund të kuptohet nga poeti modern Edib Harabi.

Ai thoshte:

*“O i devotshëm, në xhennet nuk të sjell  
Agjërimi, adhurimi dhe abdesi që ti merr  
Eja, mos u lodh kot  
Hidhi tej hirkën, tespihët dhe sixhaden...  
Duke harruar ujin e Zemzemit pij verë..  
Pirja e verës në kuptimin e vërtetë ka shumë merita  
(Zemzem terkeyle nuseyle sarap- Hakikatte sarapicmek pek sevap..  
Mos shko në xhami, shko në tempull idhujsh  
(Camilere gitme put’haneye git) etj. (Ibid, p. 91)*

## Së dyti: Doktrinat e muridit (aspiruesit-dervishit)

1-Misteri الخفاء

Për bektashiun misteret e tarikatit janë të tilla që askush nuk mund të fillojë t’i kuptojë gjersa të ketë mësuar prej tyre sipas aftësisë së tij shpirtërore. Nuk ka libër që mund të të mësojë bektashizmin dhe nuk ka besim që mund të kuptohet pa ndihmën e murshidit (mjeshtrit).

Në librin e tyre *Noktatul Bejan*, ka një përkufizim të qartë rreth kësaj çështjeje: “Kush thotë se është kërkues i Muhammed Alisë, duhet pikësëpari – dhe kjo është thelbësore – të gjejë murshidin e vet. (*Muhamet Aliye talibim deyen, Evel, farzdir Mursidini bulmadi*). (Ibid: 96).

Ata e mbitheksojnë rëndësinë e murshidit duke thënë se: njeriu duhet të lindë dy herë siç pohon Virani Baba në *Risale*. Ai duhet të lindë nga nëna e tij dhe pastaj nga murshidi i tij. Ajo që lind nga nëna është mish. Njeriu lind në botën e realitetit vetëm nëpërmjet ndikimit të murshidit.

- Ai që nuk ka arritur murshidin nuk mund ta njohë Zotin (*Mursidi ermiyen Hakki bilmez*).

- Nëse ke një murshid mund të bëhesh insan.
- Nëse nuk ke murshid do të mbetesh hajvan. (*Mursitin var ise olursan insan - Mursitin yok ise kalirsin hayvan*) (Ibid, 97).

Tariakti bektashi ka edhe diçka të cilën e quajnë katër dyert. Pastaj është diçka e quajtur tre sunnete dhe shtatë farze, që janë doktrinat e murshidit.

Në Librin e Mistereve, *Sirr-name* që u dëshmuar nga el-Vekil Sejid Mahmud Baba i teqesë së Sehlikut në Rumeli Hisar, janë përmendur tre sunnetet, dhe çdo murid e ashik duhet t'i njohë. Këto tre sunnete janë si më poshtë:

Së pari: Të mos shqitet kurrë nga zemra dhe mendja Realiteti Hyjnor (*Yezdani Haqq*) dhe përkujtimi i Tij gjithmonë.

Së dyti: Të largohet çdo ndjenjë urrejtje që mund të ekzistojë ndaj ndonjë vëllai në fe.

Së treti: Të dorëzohemi dhe të jemi të kënaqur me çdo përvojë dhe gjendje shpirtërore (*Kahrina ve her halina teslim ve razi ola*, Ibid, f. 99).

Shtatë farzet janë si më poshtë:

- 1- Muridi duhet t'i shohë të gjitha gjërat ekzistuese si Zoti, ose Realiteti, dhe nuk duhet t'i tregojë askujt sekretin e atyre që kanë mbërritur.
- 2- Ai duhet të ruajë sekretet, nuk duhet të shohë atë që sheh dhe të dëgjojë atë që dëgjon, pra nuk duhet t'i tregojë këto asses.
- 3- Ai duhet ta meditojë Realitetin Hyjnor (*Jezdani Hakk*) për çdo gjë të keqe që vjen në ekzistencë si rezultat i harrimit të Realitetit Hyjnor.
- 4- Ai duhet t'i konsiderojë mësimet dhe udhëzimin e murshidit të tij si hakk – realitet, dhe nuk duhet të veprojë sipas dëshirës së vet. Në fillim, kur ta ketë gjetur murshidin, ai do t'i tregojë dhe zbulojë fytyrën e pa velë të Zotit (*Hicabsiz Cemal Ullah*).
- 5- Kështu që ai duhet të sjellë tek murshidi veten e duhur dhe nuk duhet të vijë duarzbrazur, dhe kjo konsiderohet nga bektashinjtë si abdes الوضوء që ai t'i sjellë dhurata me rëndësi mjeshtrit të tij.
- 6- Ai duhet të marrë dorën e murshidit, halifes dhe me dorën e Zotit duhet të rrëfëhet dhe pendohet الإعتراف و التوبة .
- 7- Duke shkuar te murshidi ai duhet të heqë dorë nga çfarë di dhe të jetë i përunjët përpara ehl-i tarikatit (*Ibid,100*).



Në këtë pikë, pra murshidi përshkruhet si stërvitës (Murabbi), si pasues dhe përfaqësues i kryeshenjtorit ( الوالي ), dhe si mjeshtër në artin e të jetuarit të përshpirtshëm.

Mistiku i famshëm nga Turkistani, Ahmed Jeseviu pati ndikim të fuqishëm mbi bektashinjtë dhe nakshbenditë. Ai jetoi në shekullin XIII. Në librin e tij *Ilk Mutasavifler* ai përmend parimet e rrugës së tij:

- 1- Aspiruesi (Murid) duhet t'i dorëzohet krejtësisht shejhut të tij, dhe askush nuk mund të konsiderohet përmbi të.
- 2- Ai duhet të jetë inteligjent në mënyrë që të kuptojë simbolet dhe shenjat e shejhut të tij.
- 3- Ai duhet të jetë i zgjuar dhe i shkathët në shërbim të shejhut.
- 4- Ai duhet të jetë besnik në punë dhe i palëkundur në zbatimin e këshillës së shejhut, dhe të mos bjerë kurrë në dyshim.
- 5- Ai duhet t'i pranojë dhe t'u bindet të gjitha fjalëve dhe të miratojë të gjitha veprimet e shejhut të tij.
- 6- Ai duhet të jetë besnik dhe i vendosur në bejatin e tij.
- 7- Ai duhet të jetë gati të heqë dorë nga të gjitha zotërimet për shejhun e tij.
- 8- Ai duhet t'i ruajë sekretet e shejhut të tij dhe të ruhet nga përhapja e tyre.
- 9- Ai duhet të tregojë respekt për këshillën e shejhut të tij dhe të mos jetë gafil.
- 10- Ai duhet të jetë i gatshëm të flijojë jetën dhe kokën; ai duhet të jetë mik i mikut të shejhut dhe anasjelltas!

### **Së treti: Doktrinat e katër dyerve**

- 1- *Sheriati* sipas ligjit besimdrejtë sunni
- 2- *Tarikati* ose mësimet e rendit të fshehtë fetar
- 3- *Marifeti* ose njohja mistike e Zotit
- 4- *Hakikati* ose përvoja e pandërmjetësuar e thelbit të realitetit.

Në mësimet e Haxhi Bektashit gjejmë se Zoti ka krijuar katër grupe qeniesh njerëzore:

- 1- *Abitler*-Adhurues, që janë njerëzit e Sheriatit
- 2- *Zaditler*-Asketë që janë njerëz të Tarikatit

- 3-Arifler-Gnostikë që janë njerëz të Marifetit  
4-Muhibler-Dashurues që janë njerëz të Hakikatit.

Pas kësaj hyrjeje, ata besojnë se Zoti ka obliguar 40 shkallë (mekame) për ta njohur atë si mik. Nga këto dyzet, dhjetë kanë të bëjnë me *Sheriatin*:

- 1- *Besimi* [Kur'ani, 2:282]
- 2- *Mësimi i shkencave fetare* [Kur'ani, 3:73]
- 3- *Detyrat formale të adhurimit, agjërimit, zekatit, dhe haxhit* [Kur'ani, 2:40]
- 4- *Puna hallall pa kamatë (riba)* [Kur'ani, 2:276]
- 5- *Martesa* [Kur'ani, 4:24 ]
- 6- *Njohja e haremeve në jetën seksuale* [Kur'ani, 4:27]
- 7- *Ushtrimi i shembullit të Muhammedit a.s. dhe bashkësisë së tij* [Sunnet ve Cemaat] [Kur'ani, 48:23]
- 8- *Dhimbsuria*, [Kur'ani, 2:25]
- 9- *Pastërtia në ushqim dhe rroba* [Kur'ani, 2:54; 74:4]
- 10- *Urdhërimi për mirë dhe ndalimi nga e keqja* [Kur'ani, 3:104].

## B- Detyrat e lidhura me Tarikatin:

- 1 – *Marrja e dorës së Pirit për pendesë* (Kur'an, 3:98)
- 2- *Të bërit murid nën murshidin* (Kur'ani, 66:8)
- 3- *Prerja e flokëve dhe kthimi i rrobave* (Kur'ani, 48:27)
- 4- *Djegia në përpjekje* (Kur'ani, 2:22)
- 5- *Shërbimi*
- 6- *Frika*
- 7- *Shpresa* (Kur'ani, 39:54)
- 8- *Hirka* (الخرقة) *shporta (zembil), sixhadeja dhe urdhërimi i të mirës* (Kur'ani, 65:3)
- 9- *Patja e një mekame dhe e dashurisë* (Kur'ani, 2:160)
- 10- *Dashuria (Ashk), gëzimi (Sevkuy Safa) dhe varfëria e përshpirtshme (fakirlik)* (Kur'ani, 12:102).

## C-Detyrat e lidhura me Marifetin

- 1-Disiplina (*Edeb*)
- 2-Frika (*Korku*)
- 3-Agjërimi (*Perhiz karlik*)
- 4-Durimi (*Sabir*)
- 5-Turpi (*Utanmak*)
- 6-Bujaria (*Cumertlik*)
- 7-Varfëria (*Miskinlik*)
- 8-Dija (*Ilim*)
- 9-Njohja (*Marifet*)
- 10-Vetënjohja (*Kendiozunu bilmek*)

## D-Porta e Hakikatit ka gjithashtu dhjetë obligime

- 1- *Të bërit pluhur (Turab olmak)*
- 2- *Mosfajësimi i shtatëdhjetë e dy bashkësive fetare (yetmiş iki milleti aiplamak)*
- 3- *Mospengimi i asgjëje nga fati i saj (Elden gelen hersey ala kadrihu men etmemek)*
- 4- *Ruajtja nga bota e krijuar (dunya icinde yaratilmish ordan emin olmak)*
- 5- *Përrulja përpara Sunduesit të përfundëm (Zotit), kërkimi i Lavdisë së Tij.*
- 6- *Të folurit për misteret vetëm në praninë e mistikëve*
- 7- *Progresi shpirtëror tek Zoti (Seyr fil Lah)*
- 8- *Progresi shpirtëror dhe mbetja në qenie te Zoti (Seyr ve Baka Bil Lah)*
- 9- *Përgjërimet, Munacat*
- 10- *Soditja ose dëshmimi (Mushahadah) për të arritur tek Zoti Më i Larti (Tanri Tealaya Ulushmak) (Shih: The Bektashi Order of Dervishes, ff. 102-105).*

Përveç këtyre doktrinave ata thonë gjithashtu:

- Sheriati është në gjuhë, Tarikati në shpirt (*Sheriat dildedir Tarikat Canda*)
- Mahzun Muhamed Baba pohoi se *Muhammedi është Sheriati i parë, dhe Aliu është Tarikati* (Ibid: 106)

## **Së katërti: Disa shpjegime të tyre rreth Kur'anit**

Ata thonë se Kur'ani ka katër kuptime:

- 1-Teksti i jashtëm (**Ibare**) është për njerëzit e përgjithshëm (avamin)
- 2-Kuptimet e holla (**Lata'if**) janë për gnostikët – Arifin
- 3-Sekretet e tij (**Asrar**) janë për evliatë
- 4-E vërteta ose thelbi i tij (**Hakikat**) është për profetët (Ibid, 107).

## **Së pesti: Qëndrimet e tyre ndaj parimeve të Sheriatit**

- Ekziston një opinion i përgjithshëm se ata i neglizhojnë tërësisht praktikat fetare të kërkuara nga Sheriati, mirëpo nganjëherë ata kanë njëfarë respekti për ligjin, f. 107.
- Ata besojnë gjithashtu në وحدة الوجود والحوال , ajo që shohim në vetvete dhe në gjithësi nuk është diçka “tjetër nga Zoti” por pasqyrim i Zotit, dhe kështu e gjejmë kuptimin kënaqës të Njëshmërisë. Përvoja është misteri i: Kuntu Kenz (Isha Thesar fshehur... كنت كنزا të cilit i referohet Ibn Arabiu (Ibid:111).
- Në përputhje me shumë mistikë të tjerë islamë, bektashinjtë i përngjiten të famshmit Mensur el-Hallaxh në thënien e tij *Enne'l-Hakk* (“Unë jam e Vërteta”).
- Në kuptimin e sugjeruar nga Vera e Alastit gjendet sekreti i Sekahum أسرار سقاھم siç shkruante poeti i madh Nesimi (nga përjetësia kam pirë kupën e Sekahumit, ndaj them me çdo gllënjë: *Enne'l-Hakk* (f. 113). Dhe përvoja e pirjes së verës së Alastit është ndër misteret e tarikatit bektashi.

Genc Abdal thotë: “Kujdes, mos e trego misterin e Sekahumit (*Sekahum Sirrini Soyleme Sakin*). Me këtë përvojë përshkrimi kryesor i tesavufit plotësohet, duke nisur me konceptin e Zotit si Realitet Absolut, duke e parë Atë si bukuri e përsosur.”

## **Së gjashti: Kreu i bektashinjve shqiptarë Salih Njazi Dede tha:**

Bindja e përgjithshme e bektashinjve është se pas vdekjes shpirti i njeriut kthehet në një kafshë të tipit që i ngjan shpirti i personit. Nëse dikush ka jetuar në gjendjen shtazore ( بهيمي أو وحشي ) shpirti i tij kalon në trupin e një kafshe. Mund të jetë një derr, ose një qen, ose një tigër apo çfarëdolloj kafshe tjetër, në varësi të interesave ose shprehive të tij në këtë jetë!

## Së shtati: Doktrina të tjera

Sefil Abdel shkruan:

**Triniteti:** Zot, Muhammed, Ali janë një sekret (*Allah, Muhamed, Ali heb bir sir dir*)

Kul Himet shkruan gjithashtu: *La ilahe ilallah është dashuri, Muhammedi i Dërguari i Allahut është dashuri, Ali princi dhe miku i Zotit (veliullah) është dashuri, tre emra në kuptim një dashuri. Prite Zot që dikush t'i shohë si të ndarë nga njëri tjetri –Muhammedi është Ali, Aliu është Muhammed.*

Bektashinjtë tregojnë respekt të madh ndaj Aliut dhe Dymbëdhjetë Imamëve, të cilët i konsiderojnë si një.

**Së teti:** Bektashinjtë bëjnë pjesë në shiitët ekstremistë (gulat). Disa nga thëniet e tyre për Sejjidina Aliun r.a.:

Po t'i analizojmë këto pak thënie do ta shohim realitetin.

- 1- Unë jam prova/dëshmia (*huxhxheh*) e të gjithë profetëve - أنا حجة - الأنبياء أجمعين
- 2- Unë jam zemra e Zotit - أنا قلب الله
- 3- Unë jam vendstrehimi tek Zoti - أنا جنة الله
- 4- Unë jam formësuesi i reve - أنا منشئ السحاب
- 5- Unë jam ai që i bën njerëzit të dëgjojnë bubullimën dhe ai që bën vetëtimën - أنا مسمع الرعد و مبرق البرق
- 6- Unë jam Gjykuesi i të gjitha krijesave - أنا الذي عطا الله حساب الخلائق - أجمعين (*The Bektashi Order Dervishes*, f. 139-141).



## *Kreu i tretë*

### Rite dhe praktika

1-Ata vizitojnë teqenë, bisedojnë me Babanë dhe me pjesëtarët e rregullt, ndoshta dëgjojnë muzikë bektashiane dhe këndimin e nefesëve bektashi. (f. 162)



2-Foshnjat e tyre u sillen baballarëve për bekime dhe babai ose dedei mund të zgjedhin emër për foshnjën.

3-Në kohë trazirash ose problemesh baballarët konsultohen, ndërsa në ditë të veçanta ata vizitohen nga besimtarët.

4-Thuajse çdo teqe kanë një ose më shumë varre, të cilat janë vende zijareti.



*Në këtë foto tregohet një pjesëtar i tarikatit që rri pranë varrit të një shenjtori*

5-Ekziston liri dhe tolerancë e madhe mes bektashinjve në raport me pjesëmarrjen e grave me burrat në rite, dhe kjo përbën veçorinë më të spikatur të këtij tarikati.

6-Ka bektashinj të martuar dhe beqarë të përhershëm.

7-Gratë veshin vathë në formën e patkoit të Aliut.

8-Babai mund të veprojë si pastor në emër të pjesëtarëve të teqesë së tij dhe familjeve të tyre (*po aty*, 167).

9-Në lutjet e tyre ata mallkojnë *يلعنون* Jezidin të birin e Muavijes për shkak të masakrave ndaj familjes së Profetit dhe besimtarëve të tjerë (*Lanet Yezide Rahmet Mumine*) Ibid, 168.

10-Më 9 Mars ata festojnë ditëlindjen e Aliut, gjatë kremtimit të ditës së Novruzit, ndërsa 10 Muharremi është data e përkujtimit të Imam Huseinit. Më i miri prej tyre është ai që agjëron këto dhjetë ditë, ndërsa nga darka e datës nëntë deri në pasditen e datës dhjetë ata kujtojnë vuajtjen e Huseinit duke mos pirë ujë.

11-Shërbimi i pendesës, të cilin ata e quajnë *Bash Okumak*. Kjo ceremoni përfshin shkuarjen e një personi tek Babai për të pastruar mëkatet dhe marrë falje, dhe në këtë ceremoni larjeje të gjynaheve *Tat'hiri zunub*, ata sjellin instrumentet e tyre, *nefeset*, një dele flijohet dhe gatuhet, dhe ky shërbim vazhdon deri në mëngjes.



*Bektashian gjatë këndimit me instrumente tradicionale turke.*



*Grup të rinjsh bektashinj gjatë këndimit.*

12-Thuhet se mes bektashinjve një burrë dhe bashkëshortja e tij nuk mund të marrin nasib nga i njëjti Baba. Secili konsiderohet fëmijë tarikati i Babait që vepron si murshid në inicim التلقين , prandaj burri dhe gruaja që kanë marrë dorë nga i njëjti Baba konsiderohen si vëlla e motër dhe nuk mund të bashkohen në martesë (Shih: *The Bektashi Order of Dervishes*, f. 172).

13- Sa i përket jetës etike, murshidi e konsideron veten ligjvënësi i epërm. Shejhu i dervishëve, shkruan Ubcini në librin e tij *Letters on Turkey in 1856*, thotë “... nuk ka ligj përveç meje, unë jam ligji. E mirë është ajo që urdhëroj unë, e keqe është ajo që ndaloj unë. Duhet të vrasësh nënën dhe sovranin nëse të urdhëroj unë, se verdikti im është verdikti i Zotit.” (*The Bektashi Order*, f. 202)

14-Sekretshmëria dhe liria sociale që u jepet grave dhe përdorimi ritual i pijeve alkoolike شراب كحولي مسكر e bëri të pashmangshme që Babai të ngrihej dhe të zhvillonte popullaritetin e tij dhe të ndërtonte një grup shoqëror në teqenë e tij duke pranuar ata që nisën të keqpërdornin privilegjet e dhëna, dhe kjo shkaktoi përhapjen e namit të keq. (*The Bektashi Order*, f. 202)



*Kërcim i pjesëtarëve të tarikatit bektashi, në të cilin marrin pjesë edhe gratë me burra.*



*Pjesëtare e tarikatit bektashi. Pamje që tregon lirinë e tarikatit, pirjen e duhanit etj.*

## ***Kreu i katërt***

### **Katekizëm bektashian ( خلاصة التعاليم الشفهية للطريقة البكتاشية )**

*1-Nëse pyesin ç'është namazi, thuaju:*

Gatimi i gjërave të papjekura **طبخ الاشياء و الأطفعة الطازجة للشيخ المرشد**  
për t'i sjellë te murshidi.

*2-Nëse të pyesin ç'është abdesi الوضوء thuaju:*

Kapja pas hirkës së murshidit duke harruar të gjitha ligësitë, për të  
qenë i pastër në zemër gjithmonë.

*3- Nëse të pyesin ç'është agjërimi, thuaju:*

Të përmbajturit nga gënjeshtria dhe përfolja.

*4- Nëse pyesin ç'është haxhi, thuaju:*

Të futurit në zemrën e murshidit.

*5-Nëse pyesin ç'është zekati, thuaju:*

Varfëria e shuarjes së egos—*fakri fena*.

(Shih: *The Bektashi Order*, f. 208)



## *Kreu i pestë*

### **Bektashizmi në raport me besimet e tjera**

Siç pamë, bektashizmi është një sistem i përbërë, eklektik bindjesh dhe praktikash, dhe atij i janë shtuar elemente vazhdimisht, që prej shekullit XIII e deri tani. Këtu do të përpiqemi të përmendim disa besime, me të cilat bektashinjtë kanë lidhje ose janë të afërt...

- 1- *Alevitë*. Ata janë të afërt me alevitë, me të cilët kanë shumë pika të përbashkëta. Të dy grupet kanë bindje të ngjashme për Aliun dhe Dymbëdhjetë Imamët. Që të dy bashkuan fjalët Muhammed dhe Ali si një person në emër. Të dyja grupet i kanë bashkuar këta dy emra në trinitet me Allahun. Që të dy e njohin veten si sekt i Xhafer Sadikut. Ndikime hurufiste janë të pranishme në të dyja, tek shprehja e kuptimeve të veçanta tek gërmat dhe numrat (*Shih: The Bektashi Order, dhe A Spiritual Discourse...* ).
- 2- *Islami Sunni*. Kur diskutuam portën e Sheriatit, folëm për pjesën sunnite të këtij tarikati, ndërsa Profeti Muhammed a.s. përmendej vetëm me gojë. Ndryshe nga Aliu që përmendej nga zemra, dhe kur ata citojnë diçka nga Kur'ani Fisnik i japin shpjegim të veçantë. Dhe ky Islam sunni u përdor nga pjesëtarët e tarikatit bektashi si përlligje ose mbulojë për idetë e tyre panteiste dhe Islamin shii القائلين بوحدة الوجود që përbën karakteristikën bazë të këtij tarikati.
- 3- *Islami Shii*. Kur përmendim Dymbëdhjetë Imamët kjo është çështje themelore për ta, madje ata përdorin disimulimin (*takijja*) التُّفِيَّة.
- 4- *Shamanizmi*, bindje të lashtë aziatike ku gruaja merr pjesë me burrin në adhurim, këngë dhe himne mistike, kërcim ritual i ngjashëm me atë të shamanëve, flijimi i deles ose i qengjit në ceremoni të mëdha, mrekullitë e ngjarjeve me fluturim në ajër ose metamorfozë المسخ أو التحولات nga qenie njerëzore në zogj nga shenjtorët e tyre. Këto janë të ngjashme me historitë e Turkistanit kinez, elemente të tjera si folklori që vinin nga ndikimi budist që u fut në shamanizëm përmes Tibetit dhe Turkistanit kinez, dhe vendet ose pemët e shenjta që i kanë të përbashkëta. (*Ibid, 214*)
- 5- *Neo-Platonizmi* الأفلاطونية المحدثة. Disa ide filosofike të përdorura nga bektashinjtë dhe tarikate të tjera si: *Akl-i Kul*, *Nefs-i Kul*, *Intelekti uiversal dhe shpirti uiversal* janë pasqyrime të trinitetit të Plotinit: Shpirti Absolut, Vetja dhe Intelekti. Hadithi: “Ai që njeh veten, njeh Zotin e tij” është inversion i një ideje të gjetur në Alcibiadat pseudo-

platonike, e cila arriti tek arabët përmes neo-platonizmit. Ky hadith gjendet tek Ibn Sina dhe Ibn Arabiu.

- 6- Koncepti i hixhabit, *fenasë dhe bekasë* janë të gjitha shprehje të mendimit neoplatonist, që erdhën tek bektashinjtë përmes Ibn Arabiut dhe Rumiut. Ideja se shpirti është i pavdekshëm është një ide e Pitagorës që u shndërrua në lloje të tjera qeniesh.
- 7- Ideja e metempsikozës (التناسخ) që besohet nga shumë bektashinj gjendet edhe tek Platoni e Plotini. Tek Platoni gjejmë edhe doktrinën e murshidit, që libri nuk mund të njihet pa një mësues të gjallë që e interpreton atë, etj. (Shih: *The Bektashi order*, f. 215, si dhe: *A Spiritual discourse*).
- 8- *Krishterizmi*. Ngjashmëritë mes tarikatit bektashi dhe Krishterizmit mund të shihen në këto pika:
  - a- *Pagëzimi ose ideja* e shlyerjes së mëkateve siç e pamë.
  - b- *Krizma* التمسح بالزيت المقدس, si në sakramentin lindor të konfirmimit.
  - c- *Eukaristi i shenjtë* القربان المقدس Simboli i vdekjes së Krishtit, ata përdorin verë dhe bukë në ceremonitë e vuajtjeve të Huseinit, dhe vetëm të iniciuarit besnikë lejohen të marrin pjesë në to الأشخاص الملقنون من الشيخ أو المرشد.
  - d- *Pendesa* الندم والتوبة i ngjan shërbimit të Bash Okumak ose Magfireti Zunub. Shkishërimi ushtrohet edhe në Kishën e Krishterë.
  - e- *Martesa e ndershme* në prani të priftit është si martesa bektashiane e kryer nga Babai etj. (Shih për më gjerë: *The Bektashi Order of Dervishes*, f. 216-217).

## *Kreu i gjashtë*



### *Thënie të Baba Rexhebit*

"...Dy cilësitë më të rëndësishme njerëzore janë dija dhe mirësia. Dija dhe njohuria shtrojnë rrugën drejt Zotit. Mirësia të aftëson të durosh vuajtje dhe fyerje nga avami... Mbase të duket teprim që ngulmoj pareshtur se njeriu duhet të bëjë çmos të luftojë egon e tij. Besomë, egoizmi është si një mal i lartë përpara syve tanë, dhe Zoti është pas këtij mali. Po s'e zaptuam këtë mal, nuk do ta shohim Zotin kurrë."

Baba Rexhebi lindi më 1901 në Gjirokastrë. Në moshën gjashtëmbëdhjetë vjeçare u fut në teqenë bektashiane të Zallit pranë Gjirokastrës dhe përfundoi studimet në besim, Sheriat, dhe letërsi islame me mësues privatë, sidomos Ragip Efendiun nga Delvina. Në moshën njëzet vjeçare ai fliste rrjedhshëm arabisht, turqisht, persisht, greqisht dhe italisht, përveç shqipës amtare. Ai bëri betimin e beqarisë bektashiane në moshën njëzet e një vjeçare dhe i shërbeu bashkësisë deri në Luftën e Dytë Botërore. U detyrua të linte atdheun më 1944 për shkak të kundërshtimit të komunizmit. Në fillim shkoi në kamp të të zhvendosurve në Itali, pastaj

në një teqe bektashiane në Egjipt, dhe më në fund në Amerikë ku ngriti Teqenë e parë Bektashiane Shqiptaro-Amerikane.

Verën e fundit të jetës së tij të gjatë, kur u pyet se për çfarë krenohej më shumë, Baba Rexhebi u përgjigj "Përpjekjen për t'i mësuar njerëzit rreth Bektashizmës." Ky Baba kontribuoi shumë me kurajën dhe lidërshtipin bashkësor, shkrimet e tij, sidomos *Misticizma Islame dhe Bektashisma* (Waldon: New York, 1970), dhe mënyrës së jetesës, së të dëgjuarit të njerëzve dhe lutjes për ta - shqiptarë e amerikanë, muslimanë dhe të krishterë. Ai ndërroi jetë në Gusht 1995 dhe u varros në teqenë e Miçiganit.<sup>2</sup>

---

<sup>2</sup> Frances Trix, *studente e Baba Rexhebit për 25 vjet, autore e Spiritual Discourse: Learning with an Islamic Master* (Philadelphia: University of Pennsylvania Press, 1993) Falënderime të veçanta zr. Mërgim Korça.

## ***Përfundim***

Pas udhëtimit tim në botën e sufizmit, arrita të vizitoj vetëm një prej qyteteve të tij të shumta, të quajtur bektashizëm. Fatkeqësisht, ky qytet ku kalova tre muaj duke kërkuar, lexuar, analizuar, m'u duk i padobishëm dhe me të ardhme jopremtuese për banorët e tij. Siç keni parë, gjatë krejt diskutimit e studimit tim, nuk u kam bërë asnjë kritikë të vetme ndaj bindjeve dhe doktrinave të këtij tarikati, sepse titulli i punimit ishte ***Tarikati bektashian-Hyrje në historinë dhe bindjet e tij sipas burimeve bektashiane.***

Jam përpjekur të shpalos historinë dhe doktrinën e tyre siç janë e siç i besojnë ata pa u shtuar asnjë fjalë të vetme, sipas burimeve dhe referencave që disponoja. Kam vuajtur shumë gjatë shkrimit dhe përmbledhjes. Pata rastin të marr disa materiale të rëndësishme nga vebfaqe bektashiane, në turqisht e anglisht. Veç kësaj, kisha dy referenca madhore rreth këtij tarikati, të shkruara nga studiues perëndimorë, të cilat më ndihmuan së tepërmi. Arsyeja pse nuk kam bërë asnjë koment kritik ishte se, sipas profesorit tim të respektuar Prof.Dr. Irfan Abdul Fattah (Allahu e mëshiroftë), nga Iraku, ne nuk jemi këtu për të dhënë fetva ose për të bërë gjykime rreth feve të tjera në bindjet e tyre ne kete faze te studimeve posdiplomike:Master dhe Doktorature. Synimi ynë është studimi i thellësishëm i tyre dhe mënyrës se si e shohin ata veten. Shpresoj të kem arritur të hedh ca dritë mbi këtë tarikat, për lexuesin musliman shqiptar, dhe e drejta e tij personale është që të gjykojë dhe analizojë; mbi ta. Normal për këto studime shkencore nevojiten më shumë hulumtime dhe analiza shkencore. Për mendimin tim jam përpjekur të jem shumë i përmbledhur në prezantimin tim, dhe Allahu na udhëzoftë të gjithëve.

***Dr. Hfz. Hajredin Hoxha***

11.09.2007 – 29 Sha'ban 1428

El Medinetul Munewere

Arabia Saudite



## ***Bibliografi***

- 1-L. M. J. Garnett, *The Dervishes of Turkey* (London: The Octagon Press Ltd., 1990),
- 2-I. Shah, *The Sufis*(Garden City), New York: Doubleday \& Company, Inc., 1964),J. S. Trimingham,
- 3-*The Sufi Orders in Islam* (London: Oxford at The Clarendon Press, 1971),
- 4-F. W. Hasluck, *Christianity and Islam Under The Sulltans*, vols. 1 \& 2(London: Oxford at The Clarendon Press, 1929),
- 5-A. T. Karamustafa, *God's Unruly Friends: Dervish Groups in The Islamic Later Middle Period 1200-1550*(Salt Lake City: University of Utah Press, 1994),
- 6-J. P. Brown, *The Darvishes or Oriental Spiritualism, Islam and The Muslim World*, no. 5(London: Frank Cass \& Co. Ltd., 1968),
- 7-J. K. Birge, *The Bektashi Order of Dervishes*, *Luzac's Oriental Religions Series*, vol. 7(London: Luzac \& Co., 1937),
- 8-S. Friedlander, *The Whirling Dervishes*(Albany: State University of New York Press, 1992),
- 9-F. Trix, *Spiritual Discourse: Learning with an Islamic Master, Conduct and Communication Series* (Philadelphia: University of Pennsylvania Press, 1993),
- 10-N. Menemencioglu, *The Penguin Book of Turkish Verse* (Middlesex, England: Penguin Books Ltd., 1978),
- 11-K. Silay, *An Anthology of Turkish Literature*, Indiana University Turkish Studies and Turkish Ministry of Culture Joint Series 15 (Bloomington, Indiana University Turkish Studies, 1996),
- 12-E. G. Broëne, ``*Further Notes on the Literature of the Hurufis and Their Connection with the Bektashi Order of Dervishes*,'' *Journal of the Royal Asiatic Society of Great Britain and Ireland* (1907): 533.
- 13-E. G. Browne, ``*Some Notes on the Literature and Doctrines of the Hurufi Sect.*,''*Journal of the Royal Asiatic Society of Great Britain and Ireland*(1898): 61.
- 14-G. Jacob, ``*Die Bektaschijje in ihrem Verhaltnis zu verwandten Erscheinungen*,''*Abhandlungen Der Philosophisch-Philologischen Klasse*

Der Koniglich Bayerrischen Akademie Der Wissenschaften 24.3 (1909):  
1.

15-N. Clayer, *L'Albanie, Pays des Derviches: Les Ordres Mystiques Musulmans en Albanie `a l'epoque Post-Ottomane (1912-1967)*, Osteuropa-Institut der Freien Universitat Berlin Balkanologische Veroffentlichungen, band 17 (Berlin: In Kommission bei Otto Harrassowitz-Wiesbaden, 1990),

16-E. Zengin, *Bektacism in Western Thrace: A Contribution to the History of the Propagation of Islam on Greek Territory* (Thessalonikh: Institute for Balkan Studies, 1988),

17-T. Zarcone, *Mystiques, Philosophes et Francs-Maçons en Islam, Riza Tevfik, Penseur Ottoman (1868-1949), Du Soufisme a laConfrerie*, Bibliotheque de l'Institut Français d'Etudes Anatoliennes d'Istanbul 37 (Paris: Librairie d'Amérique et d'Orient, 1993),

18-B. Noyan, *Bektasilik Alevilik Nedir* (Ankara: Sanat Kitabevi, 1987),  
A. ÖzkırmıAlevilik-Bektasilik ve Edebiyatı (Istanbul: Cem Yayınevi, Kent Basımevi, 1985),

19-C.Sener, *Alevilik Olayı, Toplumsal Bir Başkaldırının Kısa Bir Tarihçesi* (Istanbul: Yön Yayıncılık, 1989),

20-A. K. Bilgiseven, Prof. Dr. Mehmet Eröze Göre Etnik ve Dini Bölücülük (İstanbul: Türk Dünyası Araştırma Vakfı, 1991),

İ. Gündüz, *Osmanlılarda Devlet-Tekke Münasebetleri* (Ankara: Seha Neşriyat, 1984),

21-Y. N.Öztürk, *Tarih Boyunca Bektaşilik* (Istanbul: Yeni Boyut, 1990),

22-P. K. Hitti, *The Near East in History: A 5000 Year Story* (Princeton, Neë Jersey: D. Van Nostrand Company, Inc., 1961),

R. Lifchez,

23-*The Dervish Lodge: Architecture, Art, and Sufism in Ottoman Turkey, Comparative Studies on Muslim Societies*, No. 10 (Berkeley: University of California Press, 1992),

24-L. M. Garnett, *Mysticism and Magic in Turkey: An Açount of the Religious Doctrines, Monastic Organisation and Ecstatic Powers of the Dervish Orders* (AMS Press, 1912).

25-I. Melikoff, *Hadji Bektach: UN Mythe Et Ses Avatars: Genese Et Evolution Du Soufisme Populaire En Turquie, Islamic History and Civilization, Studies and Texts*, no. 5 (New York?: Brill Academic Publishers, 1998).